

## **STATUTI**

### **I SHOQERISE TREGETARE « DIZAYN GAZ » SH.A.**

#### **KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe adresa e shoqërise**

#### **Neni 1**

##### **Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot më 17.12.2012, ne, themeluesit, bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për tregëtarët dhe shoqëritë Tregtare» dhe të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, kemi krijuar një shoqëri aksionere me emrin «**DIZAYN GAZ» Sh.A.**
2. Themeluesit e shoqërisë janë :

- Kerim Bayramoglu
- Ilirjan Abazaj
- Taulant Brehamaj

#### **Neni 2**

##### **Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtëm:

- Mbushje dhe depozitime të Gazit Natyror dhe LPG, brenda dhe jashtë vendit
- Te krijojë dhe ndërtojë linja tubacionesh për shpërndarjen
- Të kryej transport për gaz natyror dhe LPG
- Depozitim, mbushje dhe shpërndarje të Gazit Natyror dhe LPG
- Shitje më shumicë dhe pakicë si dhe eksport – import të gazit LPG

#### **Neni 3**

##### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë 10 vjet me të drejtë shtyrje të këtij afati me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në përputhje më ligjet shqiptare në fuqi.

#### **Neni 4**

##### **Selia, adresa e faqes së internetit dhe Adresa e Elektronike**

- Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja Loni Dhamo, Bulevardi I Palmave, pallati 9 katësh. Lushnjë.

- Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është: [ëëë.bydizayn.com.tr](http://ëëë.bydizayn.com.tr)
- Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [kerim@bydizayn.com.tr](mailto:kerim@bydizayn.com.tr)

## **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 3.500.000 (tremilion e pesëqind mijë) lekë, i ndarë në 3500 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1000 lekë secili. Aksionet e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

1. Aksioneri themelues Kerim Bayramoglu: lloji i kontributit në vlerë, numri i aksioneve 2800, që përbëjnë 80 % të aksioneve të përgjithshme, dhe vlera e aksioneve 1000 lekë; vlera e kontributit 2.800.000 lekë,.
2. Aksioneri themelues Ilirjan Abazaj: lloji i kontributit në vlerë, numri i aksioneve 350, që përbëjnë 10 % të aksioneve të përgjithshme, dhe vlera e aksioneve 1000 lekë; vlera e kontributit 350.000 lekë, që përfaqëson 10 % të aksioneve
3. Aksioneri themelues Taulant Brahamaj: lloji i kontributit në vlerë, numri i aksioneve 350, që përbëjnë 10 % të aksioneve të përgjithshme, dhe vlera e aksioneve 1000 lekë; vlera e kontributit 350.000 lekë

Numri i përgjithshëm i aksioneve: 3.500, kapitali i regjistruar: 3.500.000 lekë (tremilion e pesëqind mijë) lekë, vlera e paguar: 875.000 lekë

## **Neni 6 Kërkesa për të paguar aksionet**

Administratorët mund t'u kërkojnë aksionerëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe cdo aksioner. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së aksioneve me te cilat lidhet njoftimi për pagesë.

Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

## **Neni 7 Llojet dhe kategoritë e aksioneve**

Aksionet do të jenë të zakonshme. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionerit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë.

Aksioneri Kerim Bayramoglu ka tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionerit 80 % të pjesës së fitimeve në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tij përfaqësojnë.

Aksionari Ilirjan Abazaj dhe Taulant Brahamaj kanë tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtën e aksionerit dhe për të përfituar vetëm pjesën e fitimeve në raport me pjesën e kapitalit që përfaqëson, për secilin në masën 10% të aksioneve të shoqërisë.

### **Neni 8 Regjistri i aksioneve**

Shoqëria aksionere mban një regjistër të posacëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionerit, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit dhe data e kryerjes së regjistrimit.

Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj cdo aksioneri apo cdo personi tjetër që i kërkon. Informacioni I regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin on-line të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.

Administratori i ngarkuar me detyrën e mbajtjes së regjistrit të aksioneve është Ilirjan Abazaj.

### **Neni 9 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve**

Aksionet e shoqërisë aksionere dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë, në castin e formimit të shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Aksionet dhe të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posacëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën me pikën 1 të nenit 119 të Ligjit 9901.

### **Neni 10 Zmadhimi i kapitalit themeltar**

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kotributeve të reja.  
Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh pas publikimit në QKR.
2. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshtruar vetëm nga aksionarët ekzistues.  
Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm më miratimin unanimit të të gjithë aksionarve.
3. Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

### **Neni 11** **Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligjit 9901.

Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.

Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale të parashikuar në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

### **Neni 12** **Transferimi i aksioneve**

Aksionet janë nominative. Për aksionet do të lëshohen tituj transferimi në bazë të ligjit, tipi i të cilave do të vendoset nga Këshilli Administrimit i cili do të percaktojë personat që do të firmosin titujt. Në kohën e themelimit të shoqërisë ose gjatë ekzistencës së saj mund të krijohen aksione me përparësi që kanë avantazhe në raport me të gjitha aksionet e tjera.

Aksionet janë të janë të pandashme kundrejt Shoqërisë, e cila njihet vetëm një pronar kryesor të një aksioni. Cdo aksion jep të drejtën e një vote. Në rastin

kur për një aksion ka më shume se nje zotërues, atëherë të drejtat e tyre duhet t'i ushtrojnë nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, por nëse nuk kanë caktuar përfaqësues, aksioni nuk përfaqësohet dhe ushtrimi i të drejtave që vijnë si pasojë e tij pezullohen. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga cdo aksion i ushtron vetem pruresi i tij i ligjshem.

Në rastin kur kushdo aksionar deëhiron të trasferojë një pjesë ose të gjitha aksionet e tij, është i detyruar që më përpara të bëjë të njohur me shkrim tek Këshilli Administrimit duke bërë të njohur edhe vlerën e aksioneve me qëllim që aksionarët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e përparësisë për blerjen e këtyre aksioneve. Këshilli Administrimit është i detyruar brenda dhjetë ditëve nga marrja e njoftimit përkatës të lajmërojë me shkrim të gjithë aksionarët e tjerë. Aksionarët e tjerë kanë për detyrë që brenda afatit 20 (njëzet) ditor të bëjnë të njohur tek Këshilli Administrimit nëse do të ushtrojnë të drejtën e përparësisë apo jo. Në rast se numri i aksionarëve që interesohen për blerje aksionesh është më i madh se një do të marrin aksione në përpjestim me numrin e aksioneve që zoterojnë. Cdo transferim aksionesh që bëhet në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm dhe nuk sjell rezultat të ligjshëm si për aksionarët ashtu edhe për shoqërinë.

### **KREU III**

#### **Organet e shoqërisë**

#### **Neni 13**

#### **Organet e shoqërisë**

Organet e shoqërisë aksionare janë:

1. Asambleja e përgjithshme
2. Këshilli i administrimit
3. Administratorët

#### **Neni 14**

#### **Asambleja e përgjithshme**

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin nr. 9901, e në veçanti nga dispozitat e nenit 148 të këtij ligji, të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.

1. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare;
  - b) ndryshime të statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit;
  - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
3. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i hu mbjeve;
  - c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
  - ç) vendimet për investime;
  - d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.
4. Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## **Neni 15**

### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët dhe nga anëtarët e Këshillit të Administrimit, apo nga aksionerët e përcaktuar sipas nenit 139 të Ligjit 9901.

Rastet e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i parashikon Neni 136 I Ligjit.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi 1 ditës u dërgohen të gjithë aksionarve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

### **Neni 16** **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 144 i Ligjit.

Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votive, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategoritë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.

2. Asambleja e Përgjithshme cakton një kryetar.

Në se asnjë prej administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorve nuk është i pranishëm për 15 (pesëmbëdhjetë) minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

3. Administratori ose anëtar i Këshillit të Administrimit pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si dhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e vecanta të aksionarve, zotërues të aksioneve të klasave të ndryshme.

### **Neni 17** **Kuorumi**

Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipa nenit 145 të Ligjit 9901,

asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 18** **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votive të zotëruesve të kapitalit, të aksionarve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të parashikuara në nenin 14 të këtij statuti.

### **Neni 19** **Këshilli Administrimit**

1. Asambleja e Përgjithshme cakton tre ose më shumë, por jo më shumë se 21, persona fizikë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, në pajtim me shkronjën "c", pika 2 të nenit 135 dhe pikën 2 të nenit 155 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash, I cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra në cdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.
2. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Administrimit caktohet për një periudhë 3 vjecare e cila shtyhet deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që do të miratojë tabelat financiare (rezultatet) e vitit financiar që u mbyll dhe Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet detyrimisht brenda gjashtë mujorit të parë nga mbyllja e vitit financiar.
3. Shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të jenë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.
4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktojnë një person I cili dëshiro të veprojë në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit, duke patuar parasysh se emërimi nuk përbën zmadhim të numrit të anëtarve, të përmendur në pikën 1 të këtij neni. Anëtari I Këshillit të



Administrimit I emëruar në këtë mënyrë do të jetë në detyrë deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme.

5. Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të Këshillit të Administrimit deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

- Taulant Brahamaj, me banim në Lushnjë
- Sukru Goksel, me banim në Tiranë
- Miranda Nano, me banim në Tiranë

## **Neni 20**

### **Kompetencat e Këshillit të Administrimit dhe Komiteteve të tij**

1. Këshilli i Administrimit udhëzon Administratorët në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe kontrollon përputhshmërinë e tyre me Ligjin dhe Statutin.

Detyrat e mbikqyrjes së Këshillit të Administrimit sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “i” të pikës 1 dhe 2 të nenit 154 të Ligjit, nuk mund t’iu delegohen Administratorve.

2. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregëtare të shoqërisë;
- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregëtare të shoqërisë nga administratorët;
- c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetence të kësaj të fundit, t’i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t’u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t’iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshtkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t’u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i

- këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
- f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;
  - g) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
  - gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
  - k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
  - i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, këshilli i administrimit duhet të thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

- 3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund t'i delegojnë kompetencat e tyre cdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të këtij këshilli. Delegimi i këtyre kompetencave mund të kryhet në përputhje me kushtet e vendosura nga anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe këto kompetenca mund të revokohen ose të ndryshohen. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të delegojnë detyrat që u janë ngarkuar me ligj.
- 4. Për sa më lart, Këshilli i Administrimit do të krijojë:
  - 1) Një komitet, i cili përcakton standartet për emërimin e Administratorëve;
  - 2) Një komitet, i cili përcakton skemën e shpërblimit dhe shpërblimin individual të Administratorëve dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit;
  - 3) Një komitet për kontrollin e mbarëvajtjes dhe kontabilitetit të Shoqërisë.

Komitetet përbëhen nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit të Administrimit, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të mos merren me administrimin e Shoqërisë.

- 5. Komitetet e emërimit, shpërblimit dhe kontrollit japin rekomandime të cilat synojnë përgatitjen e vendimeve që duhen marrë nga Këshilli i Administrimit. Qëllimi kryesor i komiteteve është rritja e efikasitetit të Këshillit të Administrimit duke u kujdesur që vendimet të mërren në mënyrën e duhur si dhe të ndihmojnë organizimin e punës me synim sigurimin e vendimmarrjes që nuk përbën konflikt të interesave materiale. Krijimi i komiteteve nuk zhvendos çështjet e marra në shqyrtim nga

Këshilli I Administrimit i cili mbetet organi përgjegjës për vendimet e marra në fushën e tij të kompetencës.

6. Në vecanti, komiteti i kontrollit financiar:
  - 1) Mbikëqyr procesin e raportimit financiar;
  - 2) Mbikëqyr efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemit të administrimit të rreziqeve;
  - 3) Mbikëqyr kontrollin e bilanceve vjetore dhe të konsoliduara, sipas Statutit;
  - 4) Shqyrton dhe mbikëqyr pavarësinë e ekspertit kontabël të autorizuar dhe në vecanti ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë për subjektin e kontrolluar.
7. Ndryshimet e statutit dhe udhëzimeve të Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Këshillit të Administrimit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

## **Neni 21**

### **Mbledhjet e Këshillit të Administrimit**

1. Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen të paktën 2 herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregëtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshësinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit.
2. Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me kuorumin e përcaktuar në nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar nga anëtari në momentin e emërimit.
3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërojnë njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Administrator nuk mund të emërohet si kryetar i Këshillit të Administrimit. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit të Administrimit në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm Brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
4. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votive të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
5. Të gjitha aktet e kryra nga mbledhja e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose komitetet e Këshillit të Administrimit, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, pavarësisht nëse bëhet e ditur më pas se emërimi i anëtarit të Këshillit të Administrimit ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme nëse njëlloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin

cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit të Administrimit dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

6. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose të komitetit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si I vlefshëm dhe I efektshëm njëlloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose në komitetin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.

### **Neni 22**

#### **Procesverbali I Mbledhjes së anëtarëve të Këshillit të Administrimit**

Anëtarët e Këshillit të Administrimit do të mundësojë mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve në libra të posacëm për:

1. Të gjithë emërimet e kryera nga anëtarët e Këshillit të Administrimit;
2. Të gjithë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjet e zotëruesve së aksioneve të klasave të ndryshme, dhe mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe komiteteve të Këshillit të Administrimit, përfshirë edhe emrat e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të pranishëm në këtë mbledhje.

### **Neni 23**

#### **Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit**

Detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit përfundon në rast se:

- 1) Personi nuk është më anëtar i Këshillit të Administrimit në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë nenin 157 dhe pikën 7 të nenit 158.
- 2) Personi ndodhet në gjendje paaftësie pagueese;
- 3) Personi vuan ose mund të vuajë nga crregullime mendore;
- 4) Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- 5) Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit të Administrimit në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Këshilli i Administrimit vendos ta shkarkojë nga detyra.

### **Neni 24**

#### **Administratorët**

1. Këshilli i Administrimit zgjedh një ose më shumë persona fizikë si administrator dhe përfaqësues të Shoqërisë për një periudhë tre vjecare, në pajtim më nenin 158 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të Këshillit të Administrimit, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator. Administratorët

mund të shkarkohen në cdo kohë nga detyra, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë punë e lidhur me shoqërinë.

2. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktohen si Administratorë për sa kohë që shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit përbëhet nga persona të pavarur që nuk ushtrojnë kompetenca administrimi.
3. Personat e mëposhtëm:
  - Ilirjan Abazaj
  - Kerim Bayramoglu

Caktohen si Administratorët e parë të Shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Këshillit të Administrimit të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me shkronjën "c", pika 2 të nenit 135 të Ligjit.

Aksionarët themelues autorizojnë Z. Ilirjan Abazaj që ti përfaqësojë pranë institucioneve shtetërore dhe publike për:

- Depozitimin e dokumentacionit për regjistrimin e shoqërisë pranë QKR dhe të kryejë të gjitha procedurat e ligjshme për të pëfunduar themelimin e shoqërisë
  - Për llogari të aksionarve të përpilojë dhe të nënshkruajë cdo lloj dokumenti apo deklarate, të tilla si: kontratë qiraje të ambienteve apo të mjeteve të transportit, etj., në emër të shoqërisë për marrjen e licencave përkatëse
  - Aplikimin pranë institucioneve përkatëse për licencat sipas objektit të veprimtarisë së shoqërisë
4. Politikat tregëtare të Shoqërisë do të administrohen dhe Shoqëria do të përfaqësohet nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e pikës 3 dhe 5 të nenit 158 dhe nenin 159 të Ligjit. Detyrat e Këshillit të Administrimit, në përputhje me parashikimet e shkronjave "b", c, ç, "d", "dh", "e", "ë", "f", "g", dhe "i" të pikës 1 të nenit 154 nuk mund t'iu delegohen Administratorëve.
  5. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe të udhëzimeve të Këshillit të Administrimit nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

## **Neni 25**

### **Shkarkimi I administratorëve**

1. Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- 1) Personi nuk është më administrator në bazë të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme në pajtim me pikën 2 të nenit 167, dhe shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 135 të Ligjit;
- 2) Personi ndodhet në gjendje paaftësie pagueese;
- 3) Personi vuan ose mund të vuajë nga crregullime mendore;
- 4) Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- 5) Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit të Administrimit në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim e Këshillit vendos ta shkarkojë nga detyra.

## **Neni 26**

### **Eksperti kontabël**

Eksperti kontabël i autorizuar ka për detyrë të mbikqyrë llogaritë vjetore të cilat duhet të jenë të përpiluara në bazë të rregullave ndërkombëtare të pranuar dhe të shprehin me saktësi rezultatet e periudhës ushtrimore si dhe të japin me sinqeritet dhe rezultatin e dalë në fund të vitit Financiar. Eksperti kontrollues ka dhe kompetencat që percaktohen nga legjislacioni shqiptar.

Shoqëria mban në zyrat e saj librat që kerkohen nga Ligji, ku do të mbahen llogaritë vjetore, tabelat financiare vjetore, bilancet ekonomike vjetore, raportet ekonomike vjetore, në të cilat duhet të përfshihet dhe cdo gjë tjetër që parashikohet nga ligji.

Viti financiar ka kohëzgjatje 12 muaj, duke filluar nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor të cdo viti. Përfshihet viti i parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31.12.2012.

Në fund të cdo viti financiar Këshilli Administrimit bën Regjistrimin (inventarin) dhe llogaritë vjetore në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi për Kontabilitetin, si dhe përpilon raportin për Administrimin.

Aksionarët themelues kanë caktuar si Eksperti kontabël Zj. Eleda Dhima me NIPT K93819401P dhe Licencë nr.197.

## **Kreu IV**

### **Dividendët dhe kalimi i fitimeve në Kapitalin Themeltar**

## **Neni 27**

### **Dividendët**

1. Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votive të Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarve

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjestim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividend; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividend do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
3. Asnjë dividend që nuk është kërkuar të paguhet Brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

### **Neni 28**

#### **Kalimi i Fitimeve në Kapitain Themeltar**

Administratorët, pas njoftimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 I Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividend preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

### **Kreu V**

#### **Prishja dhe njoftimet**

### **Neni 29**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posacëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionerëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë cdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksionë të klasave të ndryshme të Shoqërisë në përputhje me statutin.

### **Neni 30**

#### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 31**

## Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


### Aksionarët Themelues të shoqërisë

#### DIZAYN GAZ

KERIM BAYRAMOGLU



ILIRJAN ABAZAJ



TAULANT BREHAMAJ

